

VENDIM
Nr. 117, datë 27.2.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 540, DATË 20.9.2023, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE,
PËRGJEGJËSIVE DHE MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE E
STRUKTURAVE PËR MENAXHIMIN INDIREKT TË ASISTENCËS FINANCIARE
TË BASHKIMIT EVROPIAN NËN INSTRUMENTIN PËR ASISTENCËN E
PARAANËTARËSIMIT 2021–2027 (IPA III)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 11 e 12 të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 540, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)”, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Struktura menaxhuese e përbërë nga zyra mbështetëse e ZKA-së dhe organi kontabël, si struktura të veçanta, drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat, nën përgjegjësinë e ZKA-së, për zbatimin e programit IPA III, sipas funksioneve të përcaktuara në këtë vendim dhe në përputhje me manualët e brendshme të procedurave dhe rregulloren e brendshme të Ministrisë së Financave.”

b) Në pikën 2, fjalët “... drejtorisë mbështetëse të ZKA-së ...” zëvendësohen me “... strukturës përkatëse ...”;

c) Në pikën 3, fjalët “... Drejtorisë së Fondit ...” zëvendësohen me “... strukturës përkatëse ...”.

2. Shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) një drejtori e veçantë në organikën e ministrisë përgjegjëse për politikën e punësimit, për programin operativ shumëvjeçar në fushën e punësimit të rinjve (2024–2027).”.

3. Në pikën 3, të nenit 17, fjalët “... të paktën një herë në vit ...” zëvendësohen me fjalën “... periodikisht ...”.

4. Në pikën 4, të nenit 19, fjalët “... për monitorimin e kapaciteteve ...” zëvendësohen me “... për vlerësimin dhe monitorimin e kapaciteteve ...”.

II. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama